



Pranuar / Dorëzuar Puniljeno/Prodato Received / Delivered	24.07.2023	3	Viti Year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMISHOK	5338/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.782/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.782/2023 të datës 26.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Kaçaniku, kundër organit të punësimit Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.782/2023 e datës 26.05.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ (tutje vetëm ankuesi) më datë 26.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.782/2023, për shkak të mos veprimeve të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë për kthim në vendin e punës sipas Akt emërimit me Nr.41 të datës 12.01.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 02.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 4981/2023 të datës 30.06.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4481/2023 të datës 26.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit me Nr.41 të datës 12.01.2017; Vendimin me numër Ref.AZHB-07/4/042/2017 të datës 07.04.2017 nga Kryeshefi Ekzekutiv në AZHB; Vendimin me numër Ref.AZHB-07/4/179/2018 të datës 11.06.2018 nga Kryeshefi Ekzekutiv në AZHB; Listën e pagave të ankuesit për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2023; Komunikimin elektronik të datës 06.04.2023, 04.04.2023, 11.05.2023, 12.05.2023, 23.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe menaxhmenit në institucionin e Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollin 4981/2023 të datës 30.06.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 18.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për tek Njësia e Burimeve Njerëzore në AZHB; Përgjigjen në kërkesë përmes e-mailit zyrtar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të AZHB-së për KPMSHCK-në.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së pretendimet ankimore të ankuesit janë të *pabazuara, sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (*tutje AZHB*) ku i njëjti sipas Aktit të Emërimit Nr.41 të datës 12.01.2017 është emëruar në pozitën Inspektor-Regjioni i Ferizajt.

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur Vendimin me numër protokollit 118 të datës 07.04.2017 të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB-së, sipas të cilit ankuesi nga pozita e Zyrtarit të Lartë të Kontrollit në Divizionin e Kontrollit, është caktuar në pozitën si Zyrtar i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural në Divizionin e Projekteve të Zhvillimit Rural, ndërsa nuk ka dëshmi lidhur me transferimin e ankuesit nga pozita e Inspektorit në pozitën e Zyrtarit të Lartë të Kontrollit, kurse me Vendimin me numër protokollit 14.06.2018 të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB-së, ankuesi caktohet në punët dhe detyrat e punës si Zyrtar për Miratimin e Projekteve në kuadër të Drejtorisë për Miratimin e Projekteve në AZHB, e të cilën pozitë vijon ta ushtroj.

Ankuesi më datë 06.04.2023 dhe 12.05.2023 i është drejtuar më kërkesë Kryeshefes Ekzekutive dhe Udhëheqëses së Njësies së Burimeve Njerëzore të AZHB-së për kthimin në pozitën e punës si Inspektor sipas Akt emërimit Nr.41 të datës 12.01.2017.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 06.04.2023 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar opinion ligjor nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën si inspektor sipas akt emërimit, si dhe shfuqizimin e vendimit ku i njëjti është caktuar si Zyrtar i lartë për miratimin e projekteve në kuadër të kësaj agjencie, ndërsa ky i fundit përmes e-mailit zyrtar të datës 07.04.2023 e ka njoftuar Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore të AZHB-së, se, citoj: “... me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, transferimet e nëpunësve civil kanë pushuar të kenë bazë ligjore dhe se kërkesa e tillë nuk mund të realizohet”, ku edhe ankuesi me datën 23.05.2023 është informuar lidhur me kërkesën për opinion ligjor nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të AZHB-së.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafin 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK për çdo veprim

apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa sipas nenit 32 paragrafit 3 të këtij ligji themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit për kthimin e tij në pozitën si Inspektor sipas Akt emërimit me Nr.41 të datës 12.01.2017, Kolegji i Këshillit ka analizuar bazën ligjore mbi të cilën janë nxjerrë vendimet e kontestuara me ankesë konkretisht Vendimi me numër Ref.AZHB-07/4/042/2017 i datës 07.04.2017 si dhe Vendimi me numër Ref.AZHB-07/4/179/2018 i datës 11.06.2018 të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB-së, dhe ka konstatuar se vendimet në fjalë janë nxjerrë mbi bazën e nenit 28 paragrafit 1 dhe paragrafit 3 nën paragrafit 3.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (*ligj ky i aplikueshëm në kohën e nxjerrjeve së vendimeve*), referuar transferimit të nëpunësve civil, ku sipas të cilave dispozitave përcaktohej se: *“Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jodisiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë. 3. Ricaktimi mund të bëhet përmes: 3.1. lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale; 3.2. rotacionit në një zyrë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, por me detyra të tjera; dhe 3.3. lëvizja e përkohshme në një organizatë tjetër jashtë shërbimit civil të Kosovës; 3.4. nëpunësi civil, me pëlqimin e tij/saj dhe në marrëveshje me punëdhënësin, mund t’i nënshtrohen transferimit të përkohshëm në detyra të tjera me qëllim të dërgimit në detyrë të veçantë në një organizatë ndërkombëtare, ndërmarrje publike ose në cilëndo organizatë tjetër publike, për të cilën nevojiten aftësi dhe përvojë e caktuar profesionale. 4. Gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm nëpunësi civil gëzon statusin e pezullimit të dakorduar sipas nenit 89 të këtij ligji. 5. Ricaktimi i nëpunësve civilë do të rregullohet në hollësi me akte nënligjore.....”*, ndërsa Rregullorja Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ka përcaktuar rregullat lidhur me rregullimin dhe procedurën e transferimit të nëpunësve civil, duke paraparë me nenin 4 paragrafin 1 dy lloje të transferit dhe atë transferin e përkohshëm dhe transferin e përhershëm. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke qenë se ricaktimi i ankuesit sipas vendimeve si më lartë ishte bërë për periudhë të pacaktuar kohore, Kolegji vlerëson se caktimi i ankuesit në pozita me detyra tjera konsiderohet transferim i përhershëm, kështu që mbi këtë bazë vlerësimi dhe duke qenë se me asnjë dëshmi nuk vërtetohet fakti që ankuesi kishte kundërshtuar vendimet për transferimin e tij, atëherë Kolegji mbi bazën e këtyre fakteve vlerëson se kërkesat e ankuesit të datës 06.04.2023 dhe 12.05.2023 për kthim në pozitën e inspektorit sipas Aktit të Emërimit Nr.41 të datës 12.01.2017 janë parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin përcaktohej se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, rrjedhimisht, nisur nga përcaktimi si më sipër Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit më numër A.nr.782/2023 është e pabazuar ligjërisht, sepse ndryshimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil mund të bëhet vetëm në pajtim me dispozitat e kapitullit IV të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit të mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.782/2023

Ardita Percuku-Shyti

Ardita Percuku-Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.